



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.610/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Milena Đerić dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në hapësirë publike, për Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datë 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.10.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.610/2021 e datës 07.10.2021, e paraqitur nga subjekti politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për Zgjedhjet Lokale 2021, që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 07.10.2021, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datën 07.10.2021 në ora 11:00, aktivistët e subjektit të tyre kanë vërejtur se kandidati për Kuvendin Komunal të Prishtinës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV)-Arbër Vokri me numër 7 në listë, ka shpërndarë material zgjedhor në kundërshtim me nenin 33 pika b) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në vazhdim të ankesës pretendojnë se i njëjti ka shpërndarë materialin zgjedhor në hapësirë të palejuar, në hyrjet e banesave kolektive, brenda tyre-konkretisht në Lagjen “Dardania”, siç theksojnë se ky veprim është e ndaluar sipas nenit 33 pika b. Të LZP-së.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi kësaj ankese i ka bashkangjitur edhe dy fotografi të printuara si dhe një CD me video-inqizim.

PZAP-i me datën 07.10.2021, ka dërguar subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kërkesën për përgjigje në ankesë në të cilën i ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 08.10.2021 deri në ora 10:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 08.10.2021, subjekti politik LVV, konteston themelësinë e kësaj ankese për arsye se pretendimet e ankuesit të kandidatit të subjektit të tyre, Arbër Vokri ka shpërndarë material zgjedhor brenda hyrjeve banesore kolektive, janë supozime të rrzueshme, për faktin se brenda hapësirave të këtyre hyrjeve janë fotografuar disa vizitkarta me emrin e kandidatit të lartcekur të subjektit të tyre, veprim i cili nuk dëshmon apriori se të njëjtat janë shpërndarë nga Arbër Vokri me datën e cekur si në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës se kandidati për Kuvendin Komunal të Prishtinës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV)-Arbër Vokri me numër 7 në listë , ka shpërndarë material zgjedhor në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi në fotografit dhe CD me video incizim e bashkangjitur në ankesë shihen vetëm disa vizitkarta të shpërndara në hyrje të banesave si dhe në rrugë, të kandidatit në fjalë, me të cilën nuk dihen se nga kush janë hedhur dhe nuk shihet asnjë reklamë apo poster të vendosur në banesa kolektive me logo të subjektit LVV. Veprimet e parashtruara në ankesë janë të ndaluara vetëm në ditën e heshtjes zgjedhore dhe ditën e votimit ku sipas LZP-së, Kodit i Mirësjelljes nenit 36 -Veprimet e ndaluara para procesit të votimit, “Neni 36.1 Njëzet e katër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre u ndalohet secili prej veprimeve si mëposhtë:..... pika b) bërja e fushatës në ç’fardo mënyre” dhe se kandidatët, subjektet politike, të cilat nuk i largojnë ose postojnë materiale zgjedhore gjatë kësaj periudhe në çfardo mënyre do të raportohen në PZAP, për shkelje të këtij ligji.

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret të provuarit e asaj se shkelësit e supozuar kanë shpërndarë material zgjedhor në hapsira të palejuara konkretisht në banesa kolektive, nuk është dëshmuar me prova nga pala ankuese.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.610/2021 më datën 08.10.2021

Kryesuesi i Panelit
Zylyfi Haxhiu



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.